



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA RAJONALE E TRASHGIMISË KULTURORE KORÇË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË KONKURRIMIT PUBLIK

1. Institucioni/Autoriteti Kontraktor - **Drejtoria Rajonale e Trashgimisë Kulturore Korçë** njofton subjektet e interesuara të licencuara në zbatim, në pasuritë kulturore të marrin pjesë me ofertat e tyre publike në konkurrimin publik të shpallur nga ky institucion.
2. Emërtimin dhe vendndodhjen e objektit: **“RESTAURIM I KISHËS SË SHËN MËHILLIT NË VITHKUQ, KORÇË”**, Monument Kulture i kategorisë së I-rë.
3. Llojin e punës: **“RESTAURIM I KISHËS SË SHËN MËHILLIT NË VITHKUQ, KORÇË”**.
4. Fondi limit i procedurës së konkurrit është **prej 9.834.167 (nëntë milion e tetëqind e tridhjetë e katër mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH**, sipas preventivit të punimeve të miratuar në KKTKM.
5. Afati i realizimit të kontratës **4 muaj e gjysëm**, nga data e lidhjes së kontratës.
6. Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është **jo më pak se 8 ditë nga publikimi** i këtij njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit Kontraktor, përkatësisht data **04.09.2025 ora 09:00**, në zyrën e protokollit të institucionit, me Adresë: Lagjia 11, Rruga “Lefter Serafini”, Korçë, Shqipëri. **Ofertat e paraqitura pas këtij afati do të refuzohen.**
7. Afati dhe mënyra për tërheqjen e dokumenteve të konkurrit publik: Kandidatët e interesuar mund të aksesojnë dokumentet standarde të konkurrit publik në faqen zyrtare të Autoritetit Kontraktor: **drtkkorce.com** në Rubrikën “Njoftime”.
8. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumente ligjorë dhe administrativë origjinalë ose kopje të noterizuara si provë e plotësimit të kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentet standarde, të miratuara për këtë qëllim.
9. **Hapja e ofertave nga Njësia e vlerësimit do të jetë në datë 04.09.2025 ora 11:00** në Autoritetin Kontraktor/ **Drejtoria Rajonale e Trashgimisë Kulturore Korçë**, me Adresë: Lagjia 11, Rruga “Lefter Serafini”, Korçë, Shqipëri, dhe do të shqyrtohen brenda afatit prej 7-ditësh nga data e hapjes së tyre.
10. Ofertuesit apo Përfaqësues të autorizuar me shkrim të tyre mund të jenë të pranishëm në datën, orën dhe vendin e hapjes së ofertave.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR /OSE PERSONI I
AUTORIZUAR PREJ TIJ**

AMANDA CICI